



Pranuar / Dërguar Primijsen / Prodato Received / Delivery	14.04	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog appendis	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTOK	3565/2023		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.437/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.437 /2023 të datës 01.03.2023 të parashtruar nga ankuesja

..... kundër organit të punësimit/ Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike *"kërkesë nga marrëdhënia e punës"* duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.437/2023 e datës 01.03.2023 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ankuesja ..... e punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, sipas Akt emërimit me numër reference 158/PRK 2 të datës 28.12.2022 në pozitën *Zyrtare e Prokurimit* në Departamentin e Prokurimit, me datën 01.03.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2207/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit DM 59/2023 të datës 22.02.2023 të lëshuar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të kësaj agjencie lidhur me transferimin e nëpunësve civil pas procesit të ristrukturimit në këtë institucion, me pretendimet ankimore se e njëjta edhe pas disa viteve pune në këtë institucion është e diskriminuar dhe mban pozitë të ulët, përderisa nëpunësi Marjan Përlaska pa u shpallur konkurs për pozitën e re është emëruar si Shef i Divizionit të Prokurimit, e njëjta po ashtu pretendon se personi i cili ka fituar dhe mbajtur pozita të larta udhëheqëse në baza politike, jo meritore dhe të

kundërligjshme ndërsa sipas ankueses e njëjta ka mbajtur gjithmonë pozita të ulëta duke u diskriminuar me mos hapjen e konkursit për pozitën e re, me këtë rast e njëjta kërkon nga Këshilli ta detyroj DBNJ në AKP që ta anuloj vendimin për emërimin e pozitës së Shefit të Divizionit të Prokurimit dhe të shpallet konkurs me kritere profesionale për prokurim publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 03.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Agjencia Kosovare e Privatizimit. Ndërsa Këshilli me datën 14.03.2023, ka pranuar përgjigjen nga kjo e fundit në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoli: 2207/2023 të datës 01.03.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 22.02.2023 lidhur me dërgimin e vendimit për transferimin e nëpunësve civil; Vendimin DM 59/2023 të datës 22.02.2023 nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të AKP-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.03.2023 nga Agjencia Kosovare të Privatizimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të dosjes; Vendimin Nr.Ref.BD-171/61 të datës 31.10.2022 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Shkresën zyrtare me numër Nr.4591-1 të datës 15.11.2022 nga Auditorja e Përgjithshme; Vendimin me numër Nr.Ref.BD/173/3 të datës 30.11.2022 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Vendimin DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të AKP-së; Vendimin DM 37/2023 të datës 14.02.2023 nga Departamenti i Burimeve Njerëzore të AKP-së; Propozimin Nr.KR/04/2023 të datës 15.02.2023 nga Komisioni i Ristrukturimit; Akt emërimin e ankueses me numër të referencës 158/PRK 2 të datës 28.12.2022 si dhe Formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës për ankuesen.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses **është e palejuar, sepse:**

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...”*.

Se kush konsiderohet palë në procedurën administrative, Kolegji i'u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë,*

si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative". Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimitimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë", kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se vendimi i kontestuar me ankesë nuk cenon ndonjë të drejtë apo interes juridik të ankueses, gjegjësisht ankuesja nuk ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesë kundër Vendimit me numër DM 59/2023 të datës 22.02.2023 të Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ngase e njëjta vazhdon të punoj po në të njëjtën pozite të cilën e ka pasur me akt emërim edhe pas transferimit të saj me rastin e ristrukturimit, andaj si rrjedhojë dhe bazuar në këtë konstatim si dhe duke iu referuar nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankueses konsiderohet se është pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.437/2023.

**Ardita Perçuku-Shyti**

*Ardita Perçuku-Shyti*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore Gashi-Bajraktari**

*Malsore Gashi-Bajraktari*  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së